

Muslimanët, ëndja për fjalën e shkruar dhe bibliotekat



*“Nun, betohem në pendën dhe në atë çka shkruajnë!”
(Kur’an, el-Kalem, 1)*

“O ti që kërkon libra, ik nga unë,
sepse është turp i madh
që unë të të huazoj libër.
Libri është dashnorja ime në këtë botë,
Vallë, ke parë ndonjëherë që dashnorja
t’i huazohet dikujt tjetër!?”
(Zamahsheri)

Me paraqitjen e fesë islame në Gadishullin Arabik, bota filloi të merr kahe të tjera. Historia ndërroi faqen e saj të deriatëhershme. Muslimanët filluan të përhapen në shumë drejtime. Depërtimet e muslimanëve në truallin evropian u realizuan përmes Gjibraltarit (Xhebel-ut-Tarik) dhe Spanjës (më vonë El-Endeluth/Andaluzisë), Sicilisë dhe Italisë jugore. Pra, muslimanët në Evropë i kemi që në fillim të shekullit VIII.

Përhapja e kulturës dhe besimit islam përfshiu lindjen deri në Kinën qendrore, ndërsa në perëndim deri në brigjet e Atlantikut ose deri në Francën jugore. Kontaktet e para të evropianëve me kulturën islame shënuan një kthesë vendimtare në zhvillimin e mëtejshëm të lëmenjve të ndryshëm shkencorë. Falë rëndësisë së madhe që islami i dha diturisë dhe fjalës së shkruar, mjaft lëmenj shkencorë u përhapën me të madhe edhe në truallin evropian.

Që nga paraqitja e tij, Islami qëndroi në anën e shkencës, logjikës së shëndoshë dhe diturisë. Madje edhe Shkronja e parë Hyjnore ishte mësim, studim, lexim. Fenomeni ikre’ paraqitet si ujë i pijshëm në shkretëtirën e gjerë për të eturit dhe të humburit në labirintet e injorancës shekullore. Andaj mund të thuhet se parimet islame në mënyrë të vazhdueshme e obligojnë muslimanin në kërkimin e diturive, si dhe vazhdimisht nxisin në përhapjen e diturive edhe te të tjerët. I Dërguari Muhammed (a.s.) në mënyrë praktike e zbatoi qëndrimin islam ndaj diturisë. Ai vazhdimisht orvatej që ta zgjerojë nivelin arsimor të muslimanëve. Për këtë flasin qartë edhe shembujt e shumtë historik nga historia islame.

Qytetërimet islamik i ndihmoi mjaft edhe zbulimi i letrës, mjet ky i përkryer në shekullin VIII në Bagdad. Për një kohë shumë të shkurtër letra filloi të prodhohet edhe në disa qytete të tjera të shtetit islamik, si në Damask, Kajro etj. Libri i parë në letër u paraqit në Bagdad në vitin 870. Muslimanët i dhanë rëndësi tepër të madhe letrës (lexo: librit, diturisë). Andaj edhe thuhet se kultura e një populli matet me atë se sa harxhohet letra. Në shekullin XIII prodhimi i letrës u zgjerua edhe në Evropë.

Duke e ndjekur traditën historike arabe, Ibn Halduni vërteton se ekspansioni i vrullshëm kulturor islam dhe interesimi për dituritë e vjetra filloi me dinastinë abasite në mesin e shekullit VIII (mesi i shek. II sipas hixhrit). Ai thekson se kalifi El-Mensur solli mjaft vepra të ndryshme nga Bizanti, mes të cilave u gjet edhe vepra Elementet të Euklidit. Ibn Halduni vërteton se në botën islame vepra Elementet ishte vepër e parë greke që është përkthyer në gjuhën arabe¹.

Gjatë periudhës së dinastisë abasite, si edhe më vonë, Bagdadi ishte qendër kryesore e librit. Në periudhën e lulëzimit islamik në këtë qytet kishte rreth 100 librari të mëdha, shkolla nga më të ndryshmet, biblioteka të mëdha etj. Këtu ishte qendra e diturive dhe e fjalës së shkruar. Prej këtu dilnin dijetarë, filozofë dhe shkencëtarë të lëmenjve të ndryshëm. Në radhët e ithtarëve të librit dhe urtësisë dallohet kalifi Harunu'r-Rashid (766-809), bibliofil i madh i cili në pallatin e vet kishte tubuar njohësit e gjuhëve joarabe, siç ishin ata që e njihnin gjuhën greke, latine, arameje, siriane, sanskrite, persiane etj. Në bibliotekën e tij ai kishte caktuar vende të veçanta për përkthyesit që vazhdimisht punonin në përkthimet e librave që ishin me karakter të ndryshëm.

Periudha e artë e kulturës dhe qytetërimit islam lulëzoi pikërisht në kohën e kalifatit të El-Memunit (813-832) i cili Bagdadin e shndërroi në një metropol grandioz të diturisë. Ai themeloi një bibliotekë të madhe e cila në kohën e kalifatit të tij posedonte rreth një milion libra. El-Memuni (i biri i Harunu'r-Rashidit) ishte ai i cili në Bagdad kishte themeluar edhe një akademi të madhe të quajtur Bejtu'l-hikmeh (Shtëpia e urtësisë). Në kuadër të kësaj akademie ai kishte urdhëruar të ndërtohet edhe një observatorium astronomik dhe të themelohet një bibliotekë e madhe për çka kishte ndarë një shumë të hollash prej dyqind mijë dinarë. Ai angazhoi një numër të madh të dijetarëve dhe përkthyesve që dinin gjuhë të huaja². Ndër ta ishin Ibn Tarik, Ibn Mukaffa, Haxhaxh ibn Matar etj.

Përkthyesit shpeshherë edhe vetë ishin shkencëtarë, siç është rasti me tre djemtë e Shaqirit, të cilët ishin fizicientë dhe matematicientë³, njësoj si edhe Hunajni Ibn Is'haku, mjek i famshëm nga Bagdadi⁴. Hunajni (përkthyesi më i njohur i kohës së tij) ishte njohës profesional i gjuhës greke, siriane dhe asaj arabe. Gjuhën greke e kishte mësuar në Aleksandri⁵. Ai ishte orator mjaft i shkathhtë kur fliste gjuhën greke, madje e kishin dëgjuar duke e recituar Homerin në origjinal⁶. Që në moshën njëzetvjeçare Hunajni u bë anëtar i sektorit të përkthyesve, ku së shpejti arriti të njihet si përkthyes më i mirë nga gjuha greke, të cilin El-Me'muni e kishte zgjedhur edhe si revizor të veprimtarisë së "përkthyesve të tjerë të respektuar"⁷.

Ishte e domosdoshme që veprat e përkthyer të Euklidit dhe Ptolomeut nga Hunajni të shkojnë në komisionin revizionues të eksperti Thabit Ibn Kurra.

Gjatë sundimit të tre kalifëve abasidë Hunajni udhëhoqi me një shkollë të rëndësishme të përkthimeve, veprimtaria e së cilës mund të vlerësohet sipas dorëshkrimeve të shumta që arritën deri te ne. Ndër anëtarët më të njohur të kësaj shkolle duhet të përmenden: i biri i Hunajniut, Is'hak Ibn Hunajn (i cili e përktheu Fizikën dhe Etikën e Aristotelit), Al-Batriku (i cili e përktheu librin Lëvizjet e kafshëve të Aristotelit), Ibn Matariun (i cili e përktheu librin Almanaku astronomik të Ptolomeut) dhe Ibn Kurranë (i cili bënte revizion ndaj përkthimeve të Euklidit dhe Ptolomeut që i kishte përkthyer Hunajni) ⁸.

1 Мостафа ел-Абади, "Животот и судбината на старата александриска библиотека", Македонска цивилизација, 1997, Скопје, f. 174, cituar sipas; Ibn Khaldun, Prolegomeni (Al-Muqaddima), vëll. I, 892-893, 902, Beyrouth, 1958.

2 Filip Hiti, 'Istorija arapa', Veselin Masleša, botimi II, Sarajevo, 1973, f. 221-222.

3 Мостафа ел-Абади, f. 176. cituar sipas: Ibn al-Nadimit, 340.

4 Мостафа ел-Абади, f. 176.

5 Мостафа ел-Абади, f. 176.

6 Мостафа ел-Абади, f. 176.

7 Мостафа ел-Абади, f. 176.

8 Мостафа ел-Абади, f. 177.

Disa vepra primare u bënë mjaft të popullarizuara dhe ishin lëndë e shumë komenteve dhe përkthimeve. Këtu para se gjithash bëhet fjalë për Elementet e Euklidit, për Almanakun astronomik të Ptolomeut, për veprat medicinale të Galenit, si dhe për veprat e Platonit dhe Aristotelit, të cilët ishin më të vlerësuarit ndër filozofët. Po ashtu u përkthyen edhe komentet e këtyre veprave nga origjinali që ishin të shkruara në gjuhën greke. Për traktatin e Aristotelit të titulluar Për shpirtin Hunajni i përktheu edhe Komentet e Temistiut⁹.

Mjeku mysliman Ebu Bekër er-Razi (shek. IX/VII h.) shkroi kritikë për veprën e Galenit që në Perëndim ishte e njohur me titullin latin *Dubilationes ad Galenum*¹⁰. Një tjetër mjek, që quhej Ibn Nefis (shek. XIII/VII h.), i komentoi disa kapituj nga Përmbledhja e Hipokratit. Në lëmin e fizikës Ibn el-Hajthemi (XI/V h.) e rikomentoi sistemin e Ptolomeut në dy vëllime. Ato ishin; *Dubitaciones in Ptolomaeum* dhe *Zgjidhjet e dyshimeve* shikuar sipas Almanakut astronomik¹¹. Po ky autor ia kushtoi dy studime me vështrim kritik gjeometrisë së Euklidit të titulluar: *Zgjidhja e çështjeve të parashtruara te Elementet e Euklidit dhe Komentet e supozimeve të Elementeve të Euklidit*. Këto dy studime me siguri duhej të jenë komente të tërësishme të Elementeve¹². Është për t'u theksuar se nga veprat e rëndësishme të përkthyer, konsiderohej edhe *Poetika* e Aristotelit e përkthyer nga Ebu Bishr Matau në shek. X. Për veprimtarinë e përkthyesve u ndanë mjete të shumta materiale, me qëllim që të përkthehen sa më shumë libra. Librat përktheheshin nga gjuhët e tjera joarabe, siç ishin ato nga gjuhët hindu, pahlevi, shaldean, sirianishtja e vjetër, greqishtja, latinishtja dhe persishtja e vjetër¹³. Me kontributin e tij intelektual ky kalif tërhoqi një numër të madh të dijetarëve dhe mendimtarëve të asaj kohe, si dhe i stimuloi dijetarët dhe përkthyesit në punët e tyre shkencore. Librat silleshin edhe nga viset e largëta. Sipas një të dhëne historike, thuhet se në Bagdad janë sjellë më shumë se 100 deve me libra.

Në Bagdad ekzistoi edhe një bibliotekë tjetër e madhe, biblioteka e Sabir Ibn Ardashirit, e themeluar në fund të shekullit X. Përveç bibliotekave publike, në Bagdad kishte edhe mjaft biblioteka private. Thuhet se historiani i njohur El-Vahidi (vdiq në vitin 822 të erës së re) pas vdekjes së tij kishte lënë një bibliotekë mjaft të pasur - 600 arka me libra.

Në shekullin X në Shiraz (Parsi) ekzistoi një bibliotekë po ashtu grandioze të cilën e themeloi Buvejhid Add-ud-Devle. Në këtë bibliotekë kishte një numër të madh librash për të cilat kishte edhe katalog. Po ashtu edhe qyteti Rej (Parsi) kishte një bibliotekë të madhe në të cilën thuhet se pati aq shumë dorëshkrime të cilat mund të ngarkoheshin në më tepër se katërqind deve¹⁴. Historianët pohojnë se gjeografi i njohur Jakuti (shek. XIII) i kishte kaluar tre vite të tëra në bibliotekat e Mervas dhe Havarizmit në mbledhjen e materialit për Fjalorin e tij gjeografik¹⁵.

Biblioteka të mëdha ekzistuan edhe në shumë qytete tjera të botës së atëhershme islame, si në Kajro, Damask, Kufë, Fes, Tunizi, Halep, Musul, Basra, Samerkand, Kordobë, Sevilë, Malagë, Granadë, Barcelonë dhe në shumë vise të tjera. Madje, Spanja myslimane (Andaluzia) është e njohur edhe me bibliotekën e madhe të El-Hakimit II (961-976) në Kordobë (Kurtuba), e cila posedonte rreth 600.000 libra, për katalogizimin e të cilave ishin të nevojshme 44 vëllime. Madje, në Kordobë (Kurtubë), pikërisht aty pranë bibliotekës së madhe të El-Hakimit II, ekzistonte edhe një lokal i veçantë ku rishkruheshin veprat. Thuhet se gjatë një viti rishkruheshin deri më tetëdhjetë mijë libra. Në grupin e rishkruesëve kishte edhe mjaft gra që merreshin me këtë aktivitet. Qendra e përkthimeve ishte qyteti Toledo

9 Мостафа ел-Абади, f. 177-178.

10 Мостафа ел-Абади, f. 177-178.

11 Мостафа ел-Абади, f. 178.

12 Мостафа ел-Абади, f. 178, madje Euklidi konsiderohej edhe babai i gjeometrisë. Në lidhje për kontributin e arabëve (myslimanëve) në lëmin e matematikës, gjeometrisë dhe të algjebërës, ekzistojnë një varg librash dhe broshurash të autorëve të ndryshëm, ndër ta shih edhe Ranko Risojević, "Slavni arapski matematičari", Nolit, Beograd, 1988.

13 Мостафа ел-Абади, f. 177.

14 Filip Hiti, 'Istorija arapa', f. 291-292.

15 Filip Hiti, 'Istorija arapa' f. 292.

(Tuljetula), që për fat të keq që në shekullin XI ra në duart e të krishterëve. Gjatë halifatit islamik në Andaluzi, vetëm në territorin e siudhësës Iberike (Spanja e sotme) kishte rreth dyqind biblioteka të ndryshme publike. Në shoqërinë myslimane ndalu-ziane edhe shtresat më të ulëta popullore ishin entuziastë dhe ithtarë të denjë të leximit. Ishin të shumtë ata njerëz të cilët e kishin bërë traditë që të kursejnë të holla vetëm që të blejnë ndonjë libër. Ata e harxhonin edhe dinarin e fundit pikërisht për blerjen e librave.

Andaluzia shekuj me radhë zotëroi me ambientin e vërtetë intelektual ku edhe fryma tolerante ishte në nivel të duhur. Një frymë e atillë islame qartë reflektohej edhe në bashkëpunimin shkencor ndërmjet dijetarëve. Për qëndrimet dhe frymën tolerante, si dhe për bashkëpunimin shkencor në Spanjën myslimane, me mjaft entuziazëm flet edhe romansieri dhe orientalisti i njohur spanjoll Blasko Ibanjez. Ai në romanin e tij Katedralja thotë se një frymë e tillë as për së largu nuk ekziston në Spanjën e kohës së tij (gjysma e parë e shekullit XX).

Kur jemi te dashuria ndaj librit dhe fjalës së shkruar, si dhe te kultura dhe qytetërimi islam në Andaluzi, mund ta përmendim edhe vlerësimin e orientalistit Mek Kap në librin e tij Shkëlqimi i myslimanëve në Spanjë, f. 170 ku shkruan:

“Madje edhe klasat më të ulëta në shoqëri kanë qenë të etura për lexim, ndërsa punëtorët me paga modeste i kufizonin shpenzimet e tyre për ushqim dhe veshmbathje, për t’i shpenzuar paratë e fundit në blerjen e librave. Një punëtor e kishte tubuar një bibliotekë të tillë, kështu që njerëzit e shkencës tuboheshin rreth tij”¹⁶.

Për atë se sa e vlerësuan myslimanët shkencën flet edhe fakti se universitetet e para në botë u themeluan pikërisht nga myslimanët, siç është ai në Fes të Marokos i themeluar në vitin 817, universiteti Al-Az’har në Kajro, i themeluar në vitin 972 etj.

Për rëndësinë tepër të madhe që islami ia kushtoi diturisë, ndërsa myslimanët e kultivuan shekuj me radhë, flet edhe fakti që edhe xhamitë e asaj kohe u bënë qendra të librit dhe fjalës së shkruar. Të gjitha ato, siç ishin xhamia e madhe El-Mensur në Bagdad, Emevie në Damask, Al-Az’har në Kajro, El-Kajrevan në Tunizi, Xhamia e Madhe në Sana, Daru’l-Ilm në Musul, biblioteka e Ibn Thevarit në Basra, biblioteka e Ibn Shatiriut në Damask¹⁷, si dhe shumë xhami dhe biblioteka të tjera, ishin qendra të vërteta të diturisë dhe lëmenjve të ndryshëm shkencorë.

Ndër bibliotekat më të njohura të botës islame ishin: biblioteka e quajtur “Shtëpia e Urtësisë” në Kajro, biblioteka “Shtëpia e Urtësisë” në Bagdad, biblioteka e “el-Hakemit” në Kordobë, biblioteka “Familja Ammar” në Tripoli, etj. Ndërsa nga bibliotekat private më të njohura ishin: biblioteka “Fet’h Ibn Hakkan”, biblioteka “Ibn Hassab”, biblioteka “Xhemaluddin Kafti”, biblioteka “Benu Xherade”, biblioteka “Muveffeka ibn Mitran ed-Dimeshki”¹⁸, etj.

Bibliotekat dhe shkollat që ishin në territorin e shtetit islam u bënë urë lidhëse për kalimin e diturive të ndryshme në Evropën e errët. Ajo urë fatlume ishte Spanja myslimane (Andaluzia). Mendimi islam, i cili favorizon integrimin mbarëkulturore, dukshëm dhe rrënjësisht ndikoi edhe në trurin evropian...

Dr. Gustav le Bon thotë: “Në kohën kur librat dhe bibliotekat për evropianët nuk paraqitnin kurrfarë rëndësie, kalifati islamik dispononte me një numër të madh qendrash dhe bibliotekash madhështore. Për ilustrim do të përmendim “Shtëpinë e Urtësisë” së Bagdadit e cila numëronte katër milion libra, biblioteka e Sulltanit në Kajro kishte një milion, biblioteka Tripoli (në Damask) kishte tre milionë libra, ndërsa në Spanjën myslimane për çdo vit publikoheshin rreth 80 mijë libra”¹⁹.

Për entuziastët islamikë dhe për nivelin e lartë të qytetërimit dhe kulturës, G. L’Estrange kishte shkruar: “Universiteti Mensurijje (në Bagdad) ishte një objekt mahnitës dhe shumë i bukur. Ai ngrihej rreth brigjeve të lumit Tigris. Janë të njohur katër kolegjet e tij juridikë, çdonjëri nga ato me 75 studentë dhe me profesor i cili i mësonte nxënësit gratis. Studentët merrnin bursë të rregullt mujore nga një monedhë ari. Kuzhina e kolegjit i siguronte

¹⁶ Sejjid Muxhteba Musavi Lari, ‘Islami dhe civilizimi perëndimor’, Drita, Gjilan, 2004, f. 102.

¹⁷ Më gjerësisht shih: Abdulhalim Muntasir, ‘Arapsko-islamski uticaj na evropsku renesansu’ - Uticaj u oblasti matematičkih i prirodnih nauka, SIZ - Sarajevo, 1987, f. 152.

¹⁸ Mustafa Sibai, “Fenomeni islamske civilizacije”, IPA, Bihaq, 2005, f. 189-194.

¹⁹ Sejjid Muxhteba Musavi Lari, f. 100, cituar sipas, Gustav le Bon, ‘Qytetërimi islamo-arab’, vëll. III, f. 329.

ushqimet ditore. Ibn el-Furati shënoi se biblioteka përmbante edhe mjaft libra të rrallë të cilët ishin me vlerë të lartë. Ato ishin në lëmenj të ndryshëm me të cilët shërbeheshin studentët. Letra dhe lapsi ishin të siguruara për të gjithë ata që ishin të interesuar për të shkruar. Universiteti kishte banjot (hamamet) dhe ambulancën e tij. Mjekët organizonin edhe kontrole mjekësore. Ata kujdeseshin për shëndetin e studentëve, ashtu që nëse kishte ndonjë të sëmurë, ata aty për aty ia jepnin edhe ilaçin. Mos të harrojmë se gjithë kjo ishte arritur në fillim të shekullit XIII²⁰.

Nga kjo mund të themi se ato ishin kohë kur kontinenti i vjetër nuk e njihte shkrimin, madje princat evropianë mburreshin me injorancën e tyre... Në atë kohë Evropa nuk kishte asnjë qendër kulturore, ajo zhytej në errësirën e injorancës... Kjo është periudha kur bota arabo-islame dispononte me një kapacitet të madh të dijetarëve dhe qendrave të ndryshme hulumtuese.

Bibliografia

Мостафа ел-Абади, “Животот и судбината на старата александриска библиотека”, Македонска цивилизација, 1997, Скопје

Filip Hiti, ‘Istorija arapa’, Veselin Masleša, botimi II, Sarajevo, 1973

“Slavni arapski matematičari”, Nolit, Beograd, 1988.

Sejjid Muxhteba Musavi Lari, ‘Islami dhe civilizimi perëndimor’, Drita, Gjilan, 2004

Abdulhalim Muntasir, ‘Arapsko-islamski uticaj na evropsku renesansu’, SIZ - Sarajevo, 1987

Mustafa Sibai, “Fenomeni islamske civilizacije”, IPA, Bihaq, 2005

20 Sejjid Muxhteba Musavi Lari, f. 100, cituar sipas: G. L’Estrange, ‘Trashëgimia e Islamit’, f. 230. Më gjerësisht shih edhe dr. Mustafa Sibai, “Fenomeni islamske civilizacije”, IPA, Bihaq, 2005, f. 165-184.